

PËRFUNDIMI

Procesi i rekrutimit inicohet dhe realizohet nga institucioni kompetent për të siguruar mbajtjen e një niveli dhe bazë të qëndrueshme dhe profesionale të të punësuarve. Rekrutimi i zyrtarëve publikë bëhet në përputhje me nevojat për personelin që kërkohet në planet e burimeve njerëzore në përputhje me Ligjin për Zyrtar Publik dhe pas konfirmimit të disponueshmërisë së mjeteve buxhetore për pozitat e krijuara apo të lira.

Procedurën për plotësimin e vendeve të punës e shpall organi kompetent i autorizuar me statutin apo aktin e brendshëm. Procedura e rekrutimit duhet të jetë në përputhje me kushtet dhe kriteret e parapara me aktet juridike dhe aktet e brendshme në fuqi. Konkursi publik mbetet i hapur 30 ditë nga dita e publikimit dhe nuk duhet të përmbajë elemente diskriminuese. Konkursi publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.

Procedurat e rekrutimit zhvillohen në bazë të kërkesës për autorizimin e inicimit të procedurës së rekrutimit dhe përgatitja e dosjes së rekrutimit, vlerësimi dhe miratimi i kërkesës dhe autorizimit për rekrutim, publikimi i njoftimit për rekrutim.

Në Kosovë ekzistojnë disa ligje dhe rregullore, të cilat garantojnë trajtim të barabartë në procedurën e rekrutimit.

Zyrtarët publikë janë një nga segmentet kryesore për funksionimin e administratës shtetërore të një vendi. Një administratë publike funksionale është një nga gurë themelet e një shoqërie demokratike. Kjo ka rëndësi jetike për shkakun se shërbimi civil, qoftë në nivelin qendror apo lokal të administratës publike është ofrues kryesor i shërbimeve publike për popullin dhe efektshmëria e tij ndikon drejtpërsëdrejti në mundësinë e qytetarëve për të pasur qasje në të drejtat e tyre themelore.

Ligji për Zyrtar Publik ofron parametrat kyç të një zyrtari publik funksional. Ai parasheh që hollësitë e zbatimit të procesit të rekrutimit të përcaktohen me legjislacionin sekondar dhe të zbatohen nga organet shtetërore, të parapara me ligje, të cilat do të mundohem t'i reflektoj në kuadër të kësaj teme. Si rrjedhojë, procesi i rekrutimit të administratës publike të Kosovës është i lidhur pandashmërisht me standardet e njohura ndërkombëtare të qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. Një segment i rëndësishëm i shërbimit civil është edhe funksionimi i mekanizmave mbrojtës të shërbyesve civil, KPMSHCK e cila do shtjellohet në këtë temë.

Prandaj, për shkak të rëndësisë së saj kam zgjedhur një temë të tillë me qëllim të analizimit dhe hulumtimit sa më të thuktë të kësaj materie si dhe ofrimit të konkludimeve konkrete mbi procedurën e rekrutimit, vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të zyrtarëve publikë në administratën shtetërore të Kosovës.